



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0362

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Naim Shuki” B.I. kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Policia e Kosoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me flamuj te policise se Kosoves dhe flamuj shteterore” me numër të prokurimit: 214-30400-26-2218-1-2-1, me 21/07/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Naim Shuki” B.I. me nr. 2026/0362, e datës 03/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me flamuj te policise se Kosoves dhe flamuj shteterore” me numër të prokurimit: 214-30400-26-2218-1-2-1.
2. Mbetet në fuqi, aktiviteti i prokurimit “Furnizim me flamuj te policise se Kosoves dhe flamuj shteterore” me numër të prokurimit: 214-30400-26-2218-1-2-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Naim Shuki” B.I.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 15/04/2026, Policia e Kosoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me flamuj te policise se Kosoves dhe flamuj shteterore” me numër të prokurimit: 214-30400-26-2218-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim.

OE “Naim Shuki” B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03/06/2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Naim Shuki” B.I. me nr. 0362/2026 lidhur me aktivitetin “Furnizim me flamuj te policise se Kosoves dhe flamuj shteterore” me numër të prokurimit: 214-30400-26-2218-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Naim Shuki” B.I. janë parashtruar si në vijim:

Pasi kemi pranuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) dhe kemi pasur qasje në dokumentacionin e tenderit, si dhe në mostrat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik (OE) i rekomanduar për dhënie të kontratës, kemi identifikuar shkelje të rënda të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) Nr. 04/L-042, të rregullave dhe udhëzuesve në fuqi, si dhe të vetë Dosjes së Tenderit (DT).

Gjetjet, argumentet dhe arsyetimi ligjor paraqiten si në vijim:

I. Shkelja e Nenit 69 të LPP-së (Aftësia Teknike dhe Profesionale) dhe ndryshimi i kushteve të DT-së përmes “sqarimeve”

Gjatë vlerësimit të ofertave, AK është mbështetur në një “sqarim” të kërkuar nga një OE dhe këtë sqarim e ka përdorur si bazë për eliminimin e operatorit ekonomik “Naim Shuki BI”.

- Përmes këtij sqarimi, AK ka bërë ndryshime dhe shtesa të kritereve që nuk figurojnë në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit dhe as në Njoftimin për Kontratë.
- Sipas Nenit 69 të LPP-së, AK nuk ka të drejtë të shtojë apo të ndryshojë kriteret e përzgjedhjes gjatë fazës së sqarimeve pa bërë paraprakisht korrigjimin zyrtar të dokumentacionit dhe pa i njoftuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë përmes ndryshimit të Dosjes së Tenderit.
- Ky veprim e bën procesin e vlerësimit të paligjshëm dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

II. Shkelja e Udhëzuesit Operativ Nr. 002/2024 (Favorizimi i OE-së së përgjegjshëm)

Në Dosjen e Tenderit, te seksioni “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”, Kërkesa nr. 1, është kërkuar në mënyrë të qartë:

"Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog, broshurë ose foto me përshkrim detal të produkteve, me të cilat mundësohet vlerësimi i specifikacioneve teknike."

- OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar këtë kërkesë në ofertën e tij fillestare.

- Në bazë të Udhëzuesit Operativ Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, AK kishte obligim ta eliminonte dhe ta refuzonte ofertën si të papërgjegjshme, pa kërkuar informacione shtesë.
- Megjithatë, AK, në mënyrë të paligjshme dhe selektive, ka kërkuar informacione shtesë lidhur me katalogun më datë 08.05.2026, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e udhëzuesit në fuqi.

(Bashkëngjitur: Udhëzuesi Administrativ Nr. 002/2024)

III. Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi) – Standardet e dyfishta lidhur me “lidhëset”

Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, për pozicionet 1, 3, 5 dhe 6 është kërkuar në mënyrë specifike që produkti “duhet të ketë lidhëse për lidhjen e flamurit”.

- Gjatë qasjes në mostra është konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar produkte me varëse dhe jo me lidhëse, siç kërkohet në DT.
- Përkundër kësaj mospërputhjeje, oferta e tij është konsideruar e përgjegjshme.
- Ndërkohë, OE “Naim Shuki BI” është eliminuar nga Komisioni i Vlerësimit pikërisht për të njëjtën arsye, siç rezulton nga Vendimi i Autoritetit Kontraktues i publikuar më 21.05.2026.
- Ky veprim përbën shkelje të hapur të Nenit 7 të LPP-së, pasi AK ka aplikuar standarde të dyfishta, duke eliminuar një OE dhe duke shpallur përgjegjës një OE tjetër për të njëjtin devijim teknik.

IV. Mospërputhjet dimensionale dhe teknike të mostrave (tejkalimi i tolerancës prej 1%)

Gjatë verifikimit të mostrave të OE-së së rekomanduar për kontratë janë konstatuar devijime që tejkalojnë kufirin e tolerancës prej 1%, të përcaktuar nga vetë AK në Dosjen e Tenderit.

1. Flamuri Shtetëror i madh për ballkon (Pozicioni 1)

Harta e Kosovës në pjesën e poshtme ka dimension 24 cm, ndërsa në lartësi 50 cm. Yjet kanë dimension 27 cm. Harta është e vendosur dukshëm më poshtë dhe jo në mënyrë proporcionale.

Dimensionet e flamurit paraqesin devijim prej 3 cm, duke tejkalluar tolerancën e lejuar prej 1%.

Për këtë pikë, sipas Vendimit të Autoritetit Kontraktues, OE “Naim Shuki BI” është eliminuar, çka dëshmon edhe një herë trajtim jo të barabartë.

2. Flamuri Shtetëror i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 2)

- Dimensioni i kërkuar: 107 cm
- Dimensioni i dorëzuar: 105 cm

Devijimi prej 2 cm tejkalon tolerancën e lejuar prej 1%.

3. Flamuri Shtetëror i vogël për ballkon (Pozicioni 3)

- Dimensioni i kërkuar: 150 cm
- Dimensioni i dorëzuar: 153 cm

Devijimi prej 3 cm tejkalon tolerancën e lejuar prej 1%.

4. Flamuri i PK-së i madh për ballkon (Pozicioni 5)

- Dimensioni i kërkuar: 280 cm
- Dimensionet e dorëzuara: 284 cm, 285 cm dhe 297 cm

Devijimet prej 4 cm deri në 17 cm tejkalojnë dukshëm tolerancën e lejuar prej 1%.

5. Flamuri i PK-së i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 7)

- Dimensioni i kërkuar: 107 cm
- Dimensionet e dorëzuara: 104.5 cm dhe 105 cm

Devijimet prej 2 cm deri në 2.5 cm tejkalojnë tolerancën e lejuar prej 1%.

6. Flamuri i PK-së i vogël për tavolinë (Pozicioni 8)

Për dimensionet e kërkuara (gjerësia 16 cm dhe gjatësia 23 cm), mostra e dorëzuar nuk paraqet formë të rregullt simetrike.

- Gjatësia në pjesën e sipërme: 23 cm
- Gjatësia në mes: 23.3 cm
- Gjatësia në pjesën e poshtme: 22.7 cm

Ky devijim strukturor e nxjerr produktin jashtë specifikimeve teknike të kërkuara.

V. Mospërputhja e ngjyrës së flamujve me kodin e kërkuar CMYK

Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit është kërkuar në mënyrë të qartë përdorimi i ngjyrës Verdhë (ARI) me kodin:

CMYK – Ari: 0-20-62-18

- Flamujt me pozicionet 1, 3, 5 dhe 6 paraqesin dallime të theksuara në nuancë krahasuar me flamujt e pozicioneve 2, 4, 7 dhe 8.
- Flamujt e pozicioneve 2, 4, 7 dhe 8 nuk e posedojnë ngjyrën e kërkuar Verdhë (ARI) sipas kodit CMYK të përcaktuar në DT.
- Këta flamuj janë prodhuar me një nuancë të zakonshme të verdhë, e cila nuk përputhet me kodin e kërkuar dhe, rrjedhimisht, nuk i plotëson specifikimet teknike të tenderit.

PËRFUNDIM

Bazuar në të gjitha gjetjet e paraqitura më sipër, të cilat mbështeten edhe me fotografi të realizuara gjatë qasjes në mostra dhe të bashkëngjitura kësaj ankese, rezulton se Operatori Ekonomik i rekomanduar nga Autoriteti Kontraktues nuk i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe është shpallur përgjegjës në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e prokurimit publik.

Prandaj, i propozojmë dhe i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që:

1. Ta aprovojë si të bazuar këtë ankese.
2. Ta anulojë Vendimin për dhënien e kontratës.

3. Të urdhërojë kthimin e lëndës në rivlerësim në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.
4. Të realizojë vizitë zyrtare në Autoritetin Kontraktues për verifikimin dhe vlerësimin e mostrave të dorëzuara.
5. Të sigurojë që mostrat të kontrollohen në mënyrë strikte, objektive dhe në përputhje të plotë me kriteret e Dosjes së Tenderit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 05/06/2026 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0362/2026, ndërsa me datë 15/06/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0362/2026, me rekomandimet si në vijim: Eksperti Shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli Shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedural , kështu duke mbajtur edhe seance degjimore me datën : 26.06.2026, ku eksperti shqyrtues nuk ariti ti argumentoj konstatimet e tij kështu duke kërkuar që lenda të kthehet në rivlerësim me arsyetim se nuk mund të bëjë matjet e dimensioneve për shkak se metri mund të mos jetë i sakt , mirpo PSH i shqiptoj vërtetë kjo duke u bazuar në të kaluarën ku eksperti në procedura tjera ka egzaminuar mostrat tek AK-te , ku dhe kanë obligim sipas njoftimit të OSHP-se dhe kërkojë që të caktohet një super ekspertizë nga një ekspert teknik. Eksperti teknik pas verifikimit të mostrave tek AK sipas datës: 15.07.2026 , ka dorëzuar raportin PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Naim Shuki B.I.

Sa i përket pretendimeve ankimore nr. 1 dhe nr. 2, vlerësimi i tyre është në kompetencën e ekspertit shqyrtues, andaj në këtë raport nuk do të ndalemi në analizimin e tyre

Pretendimi ankimor 3.

Sipas operatorit ekonomik ankues kemi të bëjmë me pretendim ankimor si në vijim:

Në Aneksin 1 të DT-së, për flamujt me numër 1, 3, 5 dhe 6, kërkohej në mënyrë specifike që produkti "duhet të ketë lidhëse për lidhjen e flamurit".

-Gjatë qasjes në mostra, është vërtetuar se OE i rekomanduar (me çmim më të lartë) ka vendosur VARËSE dhe jo lidhëse, gjë që e bën këtë tender të papërgjegjshëm.

-Ndërsa, OE "Naim Shuki BI" është eliminuar nga komisioni i vlerësimit me të njëjtin arsyetim (për shkak të varësive në Vendimin Autoriteti Kontraktues publikuar me datë 21.05.2026).

-Kjo përbën një shkelje të hapur të Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim), pasi AK ka aplikuar kritere të dyfishta: ka eliminuar një OE dhe ka shpallur përgjegjës një OE tjetër për të njëjtin devijim teknik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3.

Sa i përket pretendimit të parë ekspertja teknike thekson se:

Me kërkesën tonë për qasje në mostrat e dorëzuara, të datës 13.07.2026, Autoriteti Kontraktues na ka mundësuar menjëherë shikimin e tyre, pa asnjë pengesë.

Më 14.07.2026 është bërë shikimi i mostrave të dorëzuara. Gjatë verifikimit teknik është konstatuar se për flamujt me numër 1, 3, 5 dhe 6, mostrat nuk posedojnë lidhëse për lidhjen e flamurit, siç është kërkuar në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, por janë të pajisura me varëse.

Prandaj, nga aspekti teknik, konstatohet se mostrat e verifikuara nuk përputhen me kërkesën e specifikuar në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, ku është kërkuar në mënyrë specifike: Flamuri, në pjesën ku vendoset shtiza (lart-poshtë) duhet të ketë lidhëse për lidhjen e flamurit për shtizë, lidhëset duhet të jene e njëjta ngjyrë si e flamurit(kaltër)si dhe duhet të jene te përforcuara në anën aty ku vendoset shtiza. (Dëshmi do bashkangjiten fotot në fund të raportit).

Andaj, ekspertja teknike në rastin konkret konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 4.

Sipas operatorit ekonomik ankues kemi të bëjmë me pretendim ankimor si në vijim:

Gjatë qasjes në mostrat e OE-së të rekomanduar për kontratë, janë matur dhe konstatuar devijime që kalojnë kufirin e tolerancës prej 1% të përcaktuar nga vetë AK-ja në Dosjen e Tenderit:

1.Flamuri Shtetëror i madh për Ballkone (Pozicioni 1): Harta e Kosovës në pjesën e poshtme është 24 cm dhe e lartë 50 cm, kurse yjet janë 27 cm. Harta është vendosur shumë poshtë dhe jo në mënyrë proporcionale. Dimensionet e flamurit kanë devijim prej 3 cm (mbi 1%). Ka dallime të qarta mes pjesës së poshtme dhe asaj të lartme (Për këtë pikë, sipas VAK-ut, OE Naim Shuki është eliminuar, që tregon sërish trajtim jo të barabartë).

2.Flamuri Shtetëror i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 2):

Dimensioni i kërkuar 107 cm – dimensioni i dorëzuar 105 cm (Devijim prej 2 cm, kalon tolerancën 1%).

3.Flamuri Shtetëror i vogël për Ballkone (Pozicioni 3): Dimensioni i kërkuar 150 cm – dimensioni i dorëzuar 153 cm (Devijim prej 3 cm, kalon tolerancën 1%).

4.Flamuri i PK-së i madh për Ballkone (Pozicioni 5): Dimensioni i kërkuar 280 cm – dimensionet e dorëzuara janë 284 cm, 285 cm dhe 197 cm (Devijim prej 3 cm deri në 5 cm, kalon dukshëm tolerancën 1%).

5.Flamur i PK-së i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 7): Dimensioni i kërkuar 107 cm – dimensionet e dorëzuara janë 104.5 cm dhe 105 cm (Devijim prej 2 cm deri në 2.5 cm, kalon tolerancën 1%).

6.Flamur i PK-së i vogël për Tavolinë (Pozicioni 8): Për dimensionin e kërkuar Gjerësia 16 cm / Gjatësia 23 cm, mostra e dorëzuar nuk është asimetrike. Gjatësia në pjesën e epërme është 23 cm, në mes 23.3 cm, ndërsa në pjesën e poshtme 22.7 cm. Ky devijim strukturor e bën produktin jashtë specifikave.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4.

Sa i përket pretendimit të dytë ekspertja teknike thekson se:

Pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankues dhe pas verifikimit teknik të mostrave të OE-së së rekomanduar për kontratë, konstatohet si në vijim:

1. Flamuri Shtetëror i madh për ballkone (Pozicioni 1)

2. Sa i përket pretendimit se harta e Kosovës nuk është e vendosur në mënyrë proporcionale, ky pretendim është i pabazuar. Gjatë verifikimit teknik është konstatuar se harta është e vendosur në mënyrë proporcionale, ku distanca nga pjesa e poshtme është 25 cm, ndërsa nga pjesa e sipërme 26 cm, çka paraqet një raport proporcional dhe të pranueshëm.

Lidhur me pretendimin për devijim të dimensioneve prej 3 cm, gjatë matjeve tona është konstatuar se dimensionin në pjesën ku vendoset shtiza është 197.3 cm, kundrejt dimensionit të kërkuar prej 200 cm, që paraqet një devijim prej rreth 1.3%. Ndërsa gjerësia e matur është 282 cm, kundrejt dimensionit të kërkuar 280 cm, e cila është brenda tolerancës së lejuar prej 1%. Flamuri Shtetëror i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 2)

Operatori ekonomik ankues pretendon se mostra e dorëzuar ka dimension 105 cm, në vend të dimensionit të kërkuar 107 cm.

Gjatë matjeve tona është konstatuar se dimensionin aktual është 105.5 cm, që paraqet një devijim prej afërsisht 1.4% nga dimensionin i kërkuar. Ky devijim e tejkalon tolerancën prej 1%, mirëpo konsiderohet një devijim shumë i vogël, i cili nga aspekti teknik nuk ndikon në funksionalitetin apo karakteristikat thelbësore të produktit.

3. Flamuri Shtetëror i vogël për ballkone (Pozicioni 3)

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues se mostra ka dimension 153 cm është i pabazuar.

Gjatë matjeve tona është konstatuar se dimensionin e flamurit është 149 cm, kundrejt dimensionit të kërkuar 150 cm, çka është brenda tolerancës së lejuar prej 1%.

4. Flamuri i PK-së i madh për përdorim të jashtëm / ballkone (Pozicioni 5)

Operatori ekonomik ankues pretendon se mostra ka dimensione 284 cm, 285 cm dhe 197 cm.

Nga matjet tona është konstatuar se dimensionet reale janë 280.5 cm dhe 200.6 cm, të cilat janë brenda tolerancës së lejuar prej 1%. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron.

5. Flamuri i PK-së i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 7)

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues është se mostra ka dimensione 104.5 cm dhe 105 cm, kundrejt dimensionit të kërkuar 107 cm.

Gjatë verifikimit teknik është konstatuar se dimensionin i matur është 106.1 cm, i cili është brenda tolerancës së lejuar prej 1% dhe për rrjedhojë përmbush kërkesën teknike.

6. Flamuri i PK-së i vogël për tavolinë (Pozicioni 8) Lidhur me pretendimin se mostra nuk është simetrike dhe nuk përmbush dimensionet e kërkuara, gjatë matjeve tona është konstatuar se

dimensionet e flamurit janë 16 cm × 23 cm, në përputhje me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Prandaj, ky pretendim nuk qëndron.

Përfundim Bazuar në verifikimin teknik të mostrave të OE-së së rekomanduar për kontratë, konstatohet se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar, për faktin se vetëm te Pozicioni 2 është konstatuar një devijim prej rreth 1.4%, i cili tejkalon në mënyrë minimale tolerancën e përcaktuar prej 1%. Ndërsa të gjitha pretendimet e tjera nuk janë konfirmuar nga matjet tona, pasi dimensionet dhe karakteristikat e mostrave rezultojnë të jenë brenda tolerancës së lejuar ose në përputhje me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit.

Andaj, ekspertja teknike në rastin konkret konstaton se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretenimi ankimor 5.

Sipas operatorit ekonomik ankues kemi të bëjmë me pretendim ankimor si në vijim:

Në Aneksin 1 të DT-së, është kërkuar në mënyrë strikte ngjyra Verdhë (ARI) me kodin: CMYK-Ari: 0-20-62-18.

- Flamujt me numra 1, 3, 5 dhe 6 kanë dallime të theksuara në nuancë me flamujt me numra 2, 4, 7 dhe 8.-

- Flamujt 2, 4, 7 dhe 8 të dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk e posedojnë ngjyrën e kërkuar Verdhë (ARI) sipas kodit CMYK, por janë prodhuar me ngjyrë të verdhë të thjeshtë me numër krejtësisht ndryshe nga kërkesa e DT-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5. Sa i përket pretendimit të tretë ekspertja teknike thekson se:

Në cilësinë e ekspertës teknike, sqaroj se nuk është e mundur të konstatohet përputhshmëria e një ngjyre me kodin specifik CMYK vetëm përmes inspektimit vizual. Verifikimi i saktë i përputhshmërisë së kodit CMYK kërkon përdorimin e pajisjeve profesionale për matjen dhe analizimin e ngjyrave, të cilat nuk kanë qenë pjesë e procesit të verifikimit të mostrave.

Gjatë analizimit të mostrave të dorëzuara nuk janë konstatuar dallime të tilla që të mund të konkludohet, vetëm mbi bazën e vëzhgimit vizual, se produktet nuk përputhen me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit.

Gjithashtu, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun teknik, në të cilin janë paraqitur specifikimet përkatëse, përfshirë edhe referencat e ngjyrave. Me dorëzimin e këtij katalogu, operatori ekonomik obligohet që gjatë ekzekutimit të kontratës të përmbahet specifikimeve teknike të deklaruara dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Bazuar në sa më sipër, duke qenë se nuk ka qenë e mundur të verifikohet përputhshmëria e kodit CMYK me mjete matëse përkatëse dhe nuk janë konstatuar mospërputhje të qarta gjatë ekzaminimit vizual të mostrave, ky pretendim ankimor konsiderohet i pabazuar nga aspekti i vlerësimit teknik të mostrave.

Andaj, ekspertja teknike në rastin konkret konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Shënim me rëndësi

Gjatë hartimit të këtij raporti janë analizuar edhe mostrat e operatorit ekonomik ankues. Nga verifikimi teknik është konstatuar se këto mostra përmbajnë mospërputhje të konsiderueshme me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për këtë arsye, analiza nuk është ndalur në mënyrë të detajuar të këto mospërputhje, edhe për faktin se vetë operatorit ekonomik ankues nuk ka kontestuar eliminimin e tij për shkak të këtyre mangësive, por pretendimet e tij janë fokusuar kryesisht në faktin se disa kërkesa teknike nuk kanë qenë të përfshira në Dosjen e Tenderit, por janë paraqitur në sqarimet e Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu, gjatë ekzaminimit vizual dhe teknik të mostrave është konstatuar se mostrat e operatorit ekonomik të rekomanduar paraqesin cilësi më të mirë për sa i përket materialit, përpunimit dhe paraqitjes së ngjyrave, krahasuar me mostrat e operatorit ekonomik ankues. (Dëshmi do bashkangjiten fotot në fund të raportit).

Rekomandimi I Ekspertit Teknik .
Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja teknike i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Ak është pajtuar me super ekspertizen, ndersa OE ankues nuk është pajtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues pas analizimit të procedurës, raportit të ekspertit shqyrtues ka ftuar seance degjimore me datën 26.06.2026, ku prezent ishin të gjitha palët ku eksperti shqyrtues nuk ariti të argumentojë konstatimet e tij në raport të poashtu edhe OE ankues në seancën degjimore nuk ariti të mbrojë veten nga eliminimi i tij në këtë procedurë për çka është eliminuar. Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket Ngjyrës së Flamujve me Kodin e Kërkuar CMYK, OE ankues pretendon se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas kodit të kërkuar, kështu duke deklaruar se janë Flamujt me numra 1, 3, 5 dhe 6 kanë dallime të theksuara në nuancë me flamujt me numra 2, 4, 7 dhe 8. Flamujt 2, 4, 7 dhe 8 të dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk e posedojnë ngjyrën e kërkuar Verdhë (ARI) sipas kodit CMYK, por janë prodhuar me ngjyrë të verdhë të thjeshtë me numër krejtësisht ndryshe nga kërkesa e DT-së, mirpo nuk ofroj ndonjë provë tjetër si shembull se cilën ngjyrë e ka ofruar andaj për PSH ky pretendim ankimor nuk mund të mbështetet pa ofruar ndonjë provë - dëshmi por vetëm me deklaratim, , ndërsa lidhur me dimensionet e flamujve Paneli Shqyrtues vendosi që të bëhet një super ekspertizë me ekspert teknik. Eksperti teknik ka dorëzuar

raportin e tij ku sipas super ekspertizes nga ekspertja teknike e cila i ka egzaminuar mostrat pran Autoritetit Kontraktues ka konstatuar citoj “ *Gjatë hartimit të këtij raporti janë analizuar edhe mostrat e operatorit ekonomik ankues. Nga verifikimi teknik është konstatuar se këto mostra përmbajnë mospërputhje të konsiderueshme me specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për këtë arsye, analiza nuk është ndalur në mënyrë të detajuar të këto mospërputhje, edhe për faktin se vetë operatori ekonomik ankues nuk ka kontestuar eliminimin e tij për shkak të këtyre mangësive, por pretendimet e tij janë fokusuar kryesisht në faktin se disa kërkesa teknike nuk kanë qenë të përfshira në Dosjen e Tenderit, por janë paraqitur në sqarimet e Autoritetit Kontraktues, Gjithashtu, gjatë ekzaminimit vizual dhe teknik të mostrave është konstatuar se mostrat e operatorit ekonomik të rekomanduar paraqesin cilësi më të mirë për sa i përket materialit, përpunimit dhe paraqitjes së ngjyrave, krahasuar me mostrat e operatorit ekonomik ankues. (Dëshmi do bashkangjiten fotot në fund të raportit)” si dhe vetëm te Pozicioni 2 është konstatuar një devijim prej rreth 1.4%, i cili tejkalon në mënyrë minimale tolerancën e përcaktuar prej 1%. Ndërsa të gjitha pretendimet e tjera nuk janë konfirmuar nga matjet tona, pasi dimensionet dhe karakteristikat e mostrave rezultojnë të jenë brenda tolerancës së lejuar ose në përputhje me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit”, ku ka ofruar edhe fotografim*

Poashtu, Paneli Shqyrtues, konsideron se duke qenë se Operatori Ekonomik nuk e ka kontestuar vendimin për eliminimin e tij, ai nuk e ka mbrojtur veten nga kjo procedure të prokurimit dhe për rrjedhojë, eliminimi i tij është bërë përfundimtar dhe i njëjti konsiderohet palë pa interes, sipas nenit 4, paragrafi 1.26 të Ligjit për Prokurimin Publik citohet “ *Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar* .

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 1 dhe 7 të LPP-së mbështet raportin e super-ekspertizës, dhe ankesën e aprovon si pjeserishte të bazuar duke vendos ta lë në fuqi” B58 Njofitmm bi vendimin e AK-se”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me flamuj te policise se Kosoves dhe flamuj shteterore” me numër të prokurimit 214-30400-26-2218-1-2-1. Nëse nuk ka ndonjë ankes tjetër për këtë aktivitet.

Ndërsa lidhur me mos korrigjimin e procedures pas përgjigjeve në sqarime të kërkuara Paneli Shqyrtues i shqipton vërejtje Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit/AK-se, duke kërkuar që çdo përgjigje në sqarime të kërkuara sikurse parashihet me nenin 53 të LPP-se, dhe ka ndryshime nga ato sipas DT-se dhe NJK, duhet të veprojnë konform nenit 24 paragrafit 24.7 të RrPP-se, në të kundërtën OSHP ka të drejt të marrë masa konform dispozitave ligjore të LPP-se dhe Rregullores së Punës së OSHP-se 83/20.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Poashtu Paneli Shqyrtues vlerëson sikurse parashihet në nenin 24 citoj 2. *Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të*

tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj'' si dhe neni 59 citoj 1. Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyësor lidhur me këtë çështje''.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Naim Shuki B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: